

2022



BAROMETRI I SIGURISË SHQIPËRI ANKETË KOMBËTARE

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

Barometri i Sigurisë Shqipëri

Anketë Kombëtare 2022

Autor

Arjan Dyrmishi

Metodologjist

Eduard Zaloshnja

Përpunimi i të dhënave

Alaattin OZDE, Albelite Design

Parathënie

Stine Klapper, Director of the Friedrich-Ebert-Stiftung, Tirana Office

Dizajni Grafik

Ergys Temali

Intervistues në terren

Agnie Konomi, Anila Gjini, Arjana Kola, Behie Alushi, Besiana Paftali, Brian Balliu, Caush Idrizi, Clirim Shehu, Elida Balla, Elma Saraci, Emidkris Troplini, Endri Habip, Eneida Sokoli, Irena Dervishi, Irena Llambi, Irma Coku, Jorida Haznedari, Leonora Celaj, Lindita Pirani, Liljana Gjinali, Olgert Bici, Omer Halili, Qazim Palushi, Rajmonda Nushi, Sami Mecollari, Shpresa Faria, Silva Shupo, Sofije Qoshku, Sonila Prushi, Vjollca Gjini, Vjollca Behluli

Mirënjohje

Ky edicion i Barometrit të Sigurisë Shqipëri, u bë i mundur me mbështetjen e Friedrich-Ebert-Stiftung, Zyra Tiranë

E drejta e autorit

© Të gjithë të drejtat janë të rezervuara për Friedrich Ebert Stiftung (FES) dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes. Asnjë pjesë e këtij studimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem për ruajtje të dhënash, ose të transmetohet, në mënyrë, elektronike, mekanike apo me çfarëdo forme tjetër, pa cituar Friedrich Ebert Stiftung (FES) dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

CSDG, Maj 2022

Parakusht

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Friedrich -Ebert -Stiftung (FES). Analizat e prezantuara në këtë raport reflektojnë vetëm perceptimet e qytetarëve dhe nuk përbëjnë në asnjë mënyrë një vlerësim përfundimtar mbi çështjet e trajtuara.

Lista e Shkurtimeve

BSSH	Barometri i Sigurisë Shqipëri
CSDG	Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
BE	Bashkimi Evropian
FES	Friedrich-Ebert-Stiftung
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
SPAK	Struktura Speciale Anti-Korrupsion
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNCAC	Konventa e OKB-së Kundër Korrupsionit

Përmbajtja

Lista e Shkurtimeve	5
Përmbajtja	6
Parathënie	7
Hyrje	9
Metodologjia	11
PYETËSORI	11
KAMPIONIMI	11
MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE.....	11
ANALIZA E TË DHËNAVE	12
Gjetjet kryesore	13
MBI KËRCËNIMET PËR SIGURINË	13
PËR SIGURINË BASHKËPUNUESE.....	13
PËR SIGURINË DHE BARAZINË GJINORE.....	15
MBI KORRUPSIONIN DHE ANTI-KORRUPSIONIN	15
Informacion demografik.....	21
Kërcënimet e sigurisë	24
Siguria bashkëpunuese	32
Siguria dhe barazia gjinore	42
Korrupsioni dhe anti-korrupsioni	50
Shtojca 1 Harta e shpërndarjes gjeografike të kampionit.....	76
Shtojca 2 Shpërndarja e kampionit në 61 bashkitë	77
Shtojca 3 Pyetësi i Anketës	79

Parathënie

Edicioni i ri i Barometrit të Sigurisë Shqipëri vjen në kohë dhe është shumë aktual. Ai ofron njohuri të rëndësishme mbi perceptimin e qytetarëve për sigurinë duke marrë parasysh ndryshimet e thella të situatës ndërkombëtare, si dhe duke i hedhur një vështrim më nga afër disa prej aspekteve më të rëndësishme të sigurisë në Shqipëri. Ne besojmë se gjetjet janë shumë të rëndësishme si për shoqërinë civile ashtu edhe për politikë –bërësit, dhe ashtu të të vlefshme për diskutime dhe zhvillimin e politikave përkatëse.

Për të zhvilluar një diskutim të informuar dhe për të hartuar politika të përshtatshme, nuk mjafton vetëm të shohim statistikën e incidenteve të lidhura me sigurinë, por lipset të merren parasysh edhe perceptimet e qytetarëve mbi kërcënimet dhe ofrimin e sigurisë si një funksion themelor i shtetit.

Këto perceptime kanë një ndikim vendimtar në shoqëri dhe në zhvillimin e saj. Besimi i qytetarëve tek shteti dhe institucionet e tij, dhe në fund të fundit tek proceset demokratike është i lidhur fort me pyetjen nëse qytetarët ndihen të sigurt dhe nëse besojnë se shteti po e ofron këtë siguri.

Ky barometër i sigurisë jep të dhëna mbi kërcënimet e perceptuara të jashtme dhe të brendshme. Për shkak të kohës së anketimit, ka qenë e mundur përfshirja e pyetjeve mbi pasiguritë e reja rajonale dhe globale. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës ka ndryshuar të gjithë sigurinë evropiane dhe rendin e paqes. Ashtu siç pritej, agresioni ka rritur shqetësimet e sigurisë edhe për qytetarët shqiptarë, veçanërisht në lidhje me brezin e ri. Për rrjedhojë, interesi për bashkëpunimin ndërkombëtar është akoma më i lartë dhe preferencat e qytetarëve janë shumë në përputhje me një orientim shumëpalësh të politikës së jashtme dhe të sigurisë së Shqipërisë. Kjo preferencë për bashkëpunim, siguri bashkëpunuese dhe multilateralizëm është një shenjë e mirë në kohët aktuale ku rendi ndërkombëtar i njohur më parë po sfidohet seriozisht.

Barometri zbulon gjithashtu gjetje të rëndësishme në dy fusha qendrore që ndikojnë në perceptimin e qytetarëve për sigurinë: nga njëra anë, sa i takon kërcënimeve të sigurisë me bazë gjinore, si dhe mungesës së barazisë dhe, dhe nga ana tjetër, sa i takon dëmtimeve të sigurisë që lidhen me korrupsionin. Të dyja çështjet kërkojnë përgjigje më të forta të politikave. Lidhjet me politikën sociale dhe fuqizimin ekonomik të grave, si dhe me kontekstin më të gjerë dhe rrënjët e padrejtësisë dhe pabarazisë gjinore duhet të merren parasysh në këtë diskutim mbi politikën, siç nënvizojnë përgjigjet në këtë anketë. Për sa i përket korrupsionit, është një zhvillim pozitiv të shihet mbështetja që i jepet institucioneve të reja si SPAK-u, që duhet konsideruar si një inkurajim për të vijuar forcimin e gjyqësorit të pavarur.

Ky edicion i Barometrit të Sigurisë Shqipëri ofron njohuri të rëndësishme që do të jenë vendimtare për punën e shoqërisë civile të angazhuar në përmirësimin e këtyre aspekteve qendrore të një kuptimi gjithëpërfshirës të sigurisë së qytetarëve shqiptarë. Gjithashtu, gjetjet mund të shërbejnë si një bazë e

shkëlqyer për zhvillimin efektiv të politikave nga vendimmarrësit. Vazhdimi i përmirësimit të ofrimit të sigurimit dhe perceptimit të qytetarëve do të ndikojë kështu pozitivisht në marrëdhëniet me institucionet shtetërore si dhe në besimin në këto institucione dhe brenda shoqërisë. Friedrich-Ebert-Stiftung përgëzon Arjan Dyrishin dhe ekipin e tij nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes për punën e tyre të rëndësishme dhe të jashtëzakonshme.

Presim me entuziazëm për diskutime të frytshme për çështjet e paraqitura.

Stine Klapper

Përfaqësuese Rezidente

Hyrje

Siguria është një funksion themelor i shtetit dhe një nga aspektet përcaktuese të çdo shoqërie demokratike dhe të bazuar në ligj. Ngjarjet ndërkombëtare të kohëve të fundit, si agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës dhe pandemia COVID-19, kanë nxjerrë në pah se si çështjet e sigurisë mund të sjellin pasoja me spektër të gjerë tek qytetarët. Ky është edicioni i katërt i Barometrit të Sigurisë Shqipëri realizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, i cili lidh sigurinë me opinionin e qytetarëve për të forcuar ndikimin e opinionit publik si në proceset e politikëbërjes në lidhje me politikat e sigurisë ashtu edhe në ofrimin e sigurisë.

Ky edicion i Barometrit të Sigurisë Shqipëri (BSSH) fokusohet në katër tema kryesore. Së pari shqyrton opinionin publik mbi aspekte të ndryshme të kërcënimeve të sigurisë. Çfarë shqetësimesh kanë shqiptarët për sigurinë dhe si përcaktohen pikëpamjet e tyre për sigurinë nga ngjarjet e ndryshme ndërkombëtare dhe në rajon? Pyetjet kërkojnë të kuptojnë se si ndihen qytetarët për shqetësimet më të gjera të sigurisë, përfshirë luftën e Rusisë kundër Ukrainës dhe kërcënimin e paraqitur nga Rusia.

Së dyti, BSSH fokusohet në aspekte që lidhen me sigurinë bashkëpunuese. Siguria bashkëpunuese përkufizohet si veprimtaria ndërmjet shteteve që synon të zvogëlojë gjasat e luftës ose pasojat e saj nëse ajo ndodh, që nuk i drejtohet ndonjë shteti apo grupi të caktuar shtetesh.¹ Siguria bashkëpunuese shpesh nënkupton punën e përbashkët të shteteve për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe shpesh përdoret si sinonim për sigurinë kolektive. Koncepti Strategjik i NATO-s i miratuar në Samitin e Lisbonës në 2010 prezantoi sigurinë bashkëpunuese si një detyrë të re thelbësore, përveç mbrojtjes kolektive ekzistuese dhe menaxhimit të krizave.

Për sa i përket arkitekturës së sigurisë, NATO, OSBE, dhe BE, përveç strukturave ombrellë gjithëpërfshirëse të OKB-së, në të cilat Shqipëria është anëtare ose që kërkon të bëhet anëtare. Pyetjet synojnë të kuptojnë opinionin e qytetarëve shqiptarë për NATO-n, OSBE-në, BE-në dhe OKB-në, rolin dhe kontributin e tyre, si dhe pritshmëritë që kanë qytetarët nga këto organizata. BSSH përfshin gjithashtu pyetje për të marrë opinionin e qytetarëve mbi bashkëpunimin për sigurinë me vendet e Ballkanit si dhe opinionin e tyre për pozitën e Shqipërisë në skenën ndërkombëtare si dhe pikëpamjet e tyre për të ardhmen.

Tema tjetër ku fokusohet BSSH është gjinia. Integrimi gjinor është bërë një çështje e rëndësishme e sigurisë dhe barazia gjinore përdoret si një tregues i fuqishëm i rritjes ekonomike dhe zhvillimit. Ky barometër ka përfshirë pyetje që synojnë të kapin opinionin e qytetarëve për tri çështje të ndërlidhura: siguria gjinore,

¹ Mihalka, Michael. "Cooperative Security: From Theory to Practice." Cooperative Security: New Horizons for International Order (2001): 1-28.

barazia, dhe mundësitë. Më konkretisht, pyetjet mbi sigurinë gjinore synojnë të kuptojnë se sa të sigurt ndjehen gratë në Shqipëri, qëndrimet kundrejt dhunës me bazë gjinore, dhe përshtatshmërinë e politikave për të garantuar barazinë në siguri për burrat dhe gratë. Si pjesë e politikës së përgjithshme të integritetit gjinor të ndërmarra nga Shqipëria gjatë dy dekadave të fundit, dhe më konkretisht në kuadrin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë², numri i grave të punësuar në sektorin e sigurisë është rritur. Për të marrë këndvështrimin e qytetarëve për efektet e zbatimit të këtyre politikave, ata u pyetën në lidhje me përfaqësimin e grave në polici dhe forcat e armatosura, mjaftueshmërinë e përfaqësimit dhe barazinë e mundësive për t'u punësuar në këto institucione. Gjithashtu, pyetjet synojnë të marrin opinionin lidhur me mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në sektorin e sigurisë, si dhe për maskulinitetin që i referohet besimit se disa punë mund të kryhen vetëm nga burrat. Në shumë shoqëri ekziston një besim i natyrshëm ose i kultivuar se gratë janë më pak të korruptuara se burrat, dhe kjo çështje ka tërhequr interesin e specialistëve të zhvillimit.³ Për të mësuar opinionin e qytetarëve shqiptarë u përfshinë edhe pyetje për prirjen e grave në çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Çështja e katërt në fokus të këtij edicioni të BSSH-së është korrupsioni. Duke qenë se korrupsioni vazhdon të jetë gangrenë për shoqërinë shqiptare në përgjithësi dhe institucioneve të sigurisë në veçanti, ky edicion i barometrit eksploron opinionin e qytetarëve mbi tendencat e korrupsionit ndër vite dhe faktorët që çojnë në praktika korruptive. Çelësi për këtë, është monitorimi i reagimeve institucionale ndaj luftës kundër korrupsionit, barometri synon të masë opinionin e publikut se si këto institucione janë përgjigjur ndaj korrupsionit dhe nivelin e besimit që qytetarët kanë në politikat e tyre.

Ndërtimi i integritetit është një komponent i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit sepse parandalon korrupsionin. Ndërtimi i integritetit përfshijë forcimin e transparencës, deklarimin e interesave dhe pasurive nga personat e përfshirë në vendimmarrjen publike, si dhe krijimin e kanaleve efektive dhe të besueshme për raportimin e korrupsionit, përfshirë sinjalizuesit. *Vetting*-u i gjyqtarëve është gjithashtu pjesë e këtyre masave të ndërtimit të integritetit. Janë përfshirë pyetje për të marrë opinionin publik edhe për këto aspekte.

Barometri eksploron gjithashtu lidhjen mes korrupsionit dhe krimit të organizuar duke tentuar të marrë opinionin e qytetarëve për ndikimin e krimit të organizuar në jetën politike dhe ekonomike të vendit. Një grup tjetër pyetjesh fokusohet tek opinionin e qytetarëve për nivelin e angazhimit të institucioneve përkatëse në luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, barometri ka mbledhur opinionet e qytetarëve në lidhje me angazhimin e tyre kundër korrupsionit dhe opinionet e tyre për mbështetjen ndërkombëtare për të luftuar korrupsionin në Shqipëri.

² Rezoluta e 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

³ Boehm, Frédéric. "Are men and women equally corrupt?" U4 Brief (2015).

Metodologjia

PYETËSORI

Pyetëtori i përdorur për këtë anketë përbëhet nga 119 pyetje me shumë zgjedhje, nga të cilat 6 janë demografike. Pyetëtori përfshin dy pyetje të paraqitura në mënyrë vijuese mbi kërcënimin më të rëndë të sigurisë dhe kërcënimin e dytë më të rëndë të sigurisë. Qëllimi i kombinimit të pyetjeve është që të dhënat e mbledhura përmes pyetjeve është të mblidhen më shumë zgjedhje të përbashkëta nga të njëjtët të anketuar (shih Aneksin 3).

KAMPIONIMI

Për këtë anketë u përdor një kampion i rastësishëm me shumë shtresa prej 1110 të rriturish. Në shtresën e parë, pyetësorët u shpërndanë proporcionalisht në 61 bashki të Shqipërisë, bazuar në popullsinë e tyre të të rriturve (shih Aneksin 2). Në shtresën e dytë, vëzhgimet u shpërndanë proporcionalisht midis zonave urbane/periferike dhe rurale brenda çdo bashkie, në mënyrë që të pasqyronin shpërndarjen e popullsisë shqiptare. Po kështu, për çdo nënshtresë u aplikuan kuota gjinore dhe moshe 50%-50%. Së fundi, nga harta e Shqipërisë u zgjodhën në mënyrë të rastësishme pika gjeografike për intervistat, sipas skemës së mësipërme të kampionimit (shih Aneksin 1).

Qëllimi i kësaj qasjeje kampionimi me shumë shtresa ishte të arrihej një përfaqësim i saktë gjeografik dhe demografik i popullsisë së të rriturve të Shqipërisë, duke ruajtur një gabim kampionimi më të ulët se $\pm 2.9\%$ për kampionin e plotë. Ky kampionim i rastësishëm me shumë shtresa siguron që çdo banor në Shqipëri të ketë probabilitet të barabartë për t'u zgjedhur për të marrë pjesë në anketë.

Duke përdorur këtë metodë kampionimi, rezultatet e anketës pasqyrojnë në mënyrën më realiste qëndrimet dhe perceptimet e popullsisë së përgjithshme të të rriturve në Shqipëri. Marzhi i gabimit statistikor për pjesën e meshkujve dhe të femrave të kampionit është llogaritur në $\pm 4,1\%$, $\pm 3,9\%$ për përfaqësimin urban të kampionit dhe në $\pm 4,4\%$ për zonat rurale dhe periferike.

MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Kjo anketë është realizuar nëpërmjet intervistave ballë për ballë, sipas planit të

kampionimit të mësipërm. Para fillimit të punës në terren, 30 intervistuesit u trajnuan nga ekipi i menaxhimit të projektit.

Puna në terren për mbledhjen e të dhënave u krye gjatë periudhës nga 24 mars-2 prill 2022. Përgjigjet e të intervistuarve u hodhën drejtpërdrejt nga intervistuesit në telefonat inteligjentë dhe u transmetuan menjëherë në serverin qendror përmes një programi softuerik të posaçëm, të ndërtuar nga Specialisti i TI të projektit.

Koha dhe vendndodhja e secilës intervistë regjistrohej automatikisht. Ky informacion përdorej çdo ditë nga drejtori i statistikave për t'u siguruar që intervistat ishin kryer në përputhje me planin e paracaktuar të kampionimit dhe udhëzimet metodologjike.

Në fund të punës në terren, u krye një kontroll i përgjithshëm i cilësisë së të dhënave të intervistave të mbledhura në server. Përpara analizës së të dhënave, kampioni u ripeshua për të pasqyruar shpërndarjen proporcionale të moshës shqiptare siç raportohet nga Instituti i Statistikave. Gjithashtu, kampioni u ripeshua politikisht, për të përfaqësuar stilistikisht përqindjet e regjistruara në zgjedhjet e fundit politike. Më pas, të dhënat u përpunuan dhe u analizuan duke përdorur softuerin statistikor STATA 13.

ANALIZA E TË DHËNAVE

Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara u analizuan duke i grupuar përgjigjet në pesë seksione kryesore.

- 1) Informacion demografik
- 2) Kërcënimet e sigurisë
- 3) Siguria bashkëpunuese
- 4) Siguria Gjinore dhe Barazia
- 5) Korrupsioni dhe Anti-korrupsioni

Analiza e të dhënave synon të pasqyrojë perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve pa u përpjekur t'i interpretojë ato, duke ia lënë kështu interpretimin audiencës. Të dhënat paraqiten në grafikë për t'i bërë ato më të kuptueshme dhe të lexueshme për lexuesit.

Gjetjet kryesore


MBI KËRCËNIMET PËR SIGURINË



Shumica dërmuese e qytetarëve perceptojnë se korrupsioni është kërcënimi më serioz për sigurinë për të katërtin vit që kur barometri u krye për herë të parë në vitin 2019.



Shumica e qytetarëve kanë shqetësime sigurie që rrjedhin nga zhvillimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një përqindje më e lartë e qytetarëve kanë shqetësime të tilla të sigurisë për të ardhmen e brezit të ri.



Shumica e qytetarëve shqiptarë mendojnë se një luftë mes Rusisë dhe Perëndimit është e mundur. Megjithatë, pothuajse e njëjta shumicë mendon se vendet perëndimore duhet të përmirësojnë marrëdhëniet me Rusinë në vend që të vendosin më shumë sanksione.



Qytetarët shqiptarë janë gjithashtu të ndarë në lidhje me masën në të cilën veprimi i Rusisë ndaj Ukrainës përbën një kërcënim sigurie për Shqipërinë. Rreth gjysma mendojnë se Rusia përbën një kërcënim shumë të madh ose një kërcënim të madh për sigurinë e Shqipërisë. Nga ana tjetër, Rusia perceptohet se përbën një kërcënim të madh ose shumë të madh për sigurinë në rajonin e Ballkanit nga gati dy të tretat e të anketuarve.



Pavarësisht shqetësimeve të shtuara të sigurisë që rrjedhin nga ndikimi në rritje i Kinës në botë, shumica e qytetarëve shqiptarë nuk mendojnë se Kina paraqet një kërcënim sigurie për Shqipërinë.




Përveç Serbisë, qytetarët shqiptarë mendojnë se vendet e tjera të Ballkanit nuk paraqesin kërcënim për sigurinë e Shqipërisë.

PËR SIGURINË BASHKËPUNUESE



Shumica e qytetarëve shqiptarë mendojnë se NATO, OSBE dhe BE kanë një ndikim pozitiv ose shumë pozitiv në sigurinë e Shqipërisë dhe mendojnë se marrëdhëniet me këto organizata do të forcohen në 5-10 vitet e ardhshme.



Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve mendojnë se këto organizata kanë një rol negativ ose se marrëdhëniet me këto organizata do të dobësohen. Megjithatë, ka një përqindje relativisht më të lartë të atyre që mendojnë se BE-ja ka ndikim negativ dhe mendojnë se marrëdhëniet do të dobësohen.



Ndonëse kjo mund të tregojë se numri i atyre që e shohin BE-në si një kontribuues negativ është më i lartë në krahasim me NATO-n dhe OSBE-në, shumica e qytetarëve mendojnë se Shqipëria duhet t'i japë prioritet marrëdhënieve të saj me BE-në.



Shumica e qytetarëve mendojnë se Shqipëria duhet t'i japë prioritet kryesor marrëdhënieve me SHBA-në, e ndjekur nga Gjermania dhe Turqia. Megjithatë, shumica e qytetarëve mendojnë se aktualisht Turqia i ofron Shqipërisë marrëdhëniet më të mira, e ndjekur nga SHBA-ja dhe Gjermania.



Shumica e qytetarëve mendojnë se Shqipëria ka nevojë për mbështetjen e aleatëve të saj për të garantuar sigurinë e saj. Shumica, por në një përqindje më e vogël mendojnë gjithashtu se Shqipëria do të jetë më e varur nga aleatët për të garantuar sigurinë e saj në 5-10 vitet e ardhshme.




Shumica e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet ndërmjet shteteve ballkanike aktualisht janë të cenuara nga mungesa e bashkëpunimit. Në mënyrë të ngjashme, shumica mendon se Shqipëria duhet të zhvillojë një bashkëpunim më të ngushtë me të gjitha vendet e Ballkanit.



Shumica e qytetarëve mendojnë se pajtimi dhe ndërtimi i paqes në Ballkan pengohet nga politikanët që përfitojnë nga mbajtja gjallë e konfliktit, pasuar nga ata që mendojnë se ndërhyrja nga fuqitë e mëdha e pengon një pajtim të tillë.



Shumica mendon gjithashtu se marrëdhëniet e sigurisë mes vendeve të Ballkanit do të përmirësohen gjatë 5 viteve të ardhshme. Një shumicë e konsiderueshme mendon se bashkëpunimi më i madh ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë do të çojë në një stabilitet më të madh në Ballkan.



Krimi i organizuar shihet nga shumica si sfida e sigurisë për të cilën Shqipëria duhet të bashkëpunojë më ngushtë me vendet e rajonit të Ballkanit.




Shumica e qytetarëve mendojnë se Shqipëria nuk ka statusin që meriton në skenën botërore. Për të përmirësuar statusin e saj në skenën botërore shumica mendojnë se Shqipëria duhet të fokusohet në zhvillimin ekonomik dhe social, ndërsa më pak mendojnë se një status i tillë mund të arrihet duke investuar më shumë në sektorin e sigurisë.

PËR SIGURINË DHE BARAZINË GJINORE




Shumica e qytetarëve mendojnë se pajtimi dhe ndërtimi i paqes në Ballkan pengohet nga politikanët që përfitojnë nga mbajtja gjallë e konfliktit, pasuar nga ata që mendojnë se ndërhyrja nga fuqitë e mëdha e pengon një pajtim të tillë.



Shumica mendon gjithashtu se marrëdhëniet e sigurisë mes vendeve të Ballkanit do të përmirësohen gjatë 5 viteve të ardhshme. Një shumicë e konsiderueshme mendon se bashkëpunimi më i madh ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë do të çojë në një stabilitet më të madh në Ballkan.




Një shumica dërrmuese e qytetarëve mendojnë se femrat shqiptare janë të përfaqësuara në mënyrë të mjaftueshme në politikë. Shumica e qytetarëve mendojnë gjithashtu se gratë janë të përfaqësuara në mënyrë të mjaftueshme në polici, por më pak se gjysma mendojnë kështu për përfaqësimin e grave në forcat e armatosura. Një shumicë e madhe e qytetarëve do të dëshironin të shihnin më shumë gra që të shërbenin si në polici ashtu edhe në forcat e armatosura.



Një shumica dërrmuese mendojnë se gratë kanë mundësi të barabarta kur aplikojnë për t'u bërë pjesë e shërbimit policor. Një përqindje më e vogël, edhe pse ende shumicë, mendojnë se gratë janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në nivele drejtuese dhe udhëheqëse në shërbimin policor.



Megjithatë, shumica më e madhe mendon se meshkujt janë më të përshtatshëm për të kryer funksionet profesionale në shërbimet policore. Të anketuarit meshkuj dhe femra ndajnë të njëjtin mendim pasi nuk vërehen ndryshime të mëdha ndërmjet gjinive në përgjigjet e dhëna.



Për shumicën e qytetarëve, gjinia duket të jetë një faktor i tendencës për t'u përfshirë në aktivitete të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Shumica e tyre mendojnë se gratë janë më pak të prirura për t'u përfshirë në korrupsion dhe krim të organizuar, megjithëse përqindja e atyre që mendojnë se gratë janë të prirura njësoj si burrat për t'u përfshirë në korrupsion është më e lartë. Megjithatë, ka disa dallime ndërmjet gjinive për një prirje të tillë, pasi një përqindje më e lartë e të anketuarve meshkuj mendojnë se gratë janë të prirura njësoj si burrat për t'u përfshirë në korrupsion dhe krim të organizuar.


MBI KORRUPSIONIN DHE ANTI-KORRUPSIONIN




Shumica dërrmuese e qytetarëve mendojnë se korrupsioni mbetet një kërcënim i madh ose shumë i madh për Shqipërinë.



Për sa i përket tendencave korruptive, shumica mendon se në pesë vitet e fundit korrupsioni është rritur ose është rritur ndjeshëm. Gjysma e të anketuarve mendojnë se në vitet që do të vijë korrupsioni do të jetë i njëjtë.




Shumica dërmuese e qytetarëve mendojnë se politikanët dhe administrata publike janë përgjegjës për vazhdimësinë e korrupsionit.



Dobësia institucionale shihet si shkaku kryesor i korrupsionit nga rreth një e treta e qytetarëve, pasuar nga pushteti i oligarkëve dhe dobësia e përgjithshme e demokracisë në Shqipëri. Shumica e qytetarëve mendojnë gjithashtu se partitë politike marrin financime nga bizneset në këmbim të favoreve.



Ka një dakordësi mbizotëruese që korrupsioni është rrënjësor aq thellë sa ta denoncosh atë nuk do të sjellë asnjë ndryshim.



Qytetarët janë të ndarë për shtrirjen e korrupsionit në fushën e punësimit në institucionet publike dhe prokurimet, por shumica mendojnë se është rritur apo ka mbetur i njëjtë në tre vitet e fundit.




Shumica e qytetarëve mendojnë se transparenca e përgjithshme e institucioneve publike ka mbetur e njëjtë gjatë tre viteve të fundit dhe po ashtu shumica mendojnë se transparenca në vendimmarrje nuk është rritur gjatë së njëjtës periudhë.



Për sa i përket seriozitetit dhe përkushtimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin, shumica e qytetarëve mendojnë se qeveria nuk është serioze në angazhimin e saj. Më shumë qytetarë mendojnë se SPAK dhe Gjykatat Kundër Korrupsionit janë serioze në angazhimin e tyre për të luftuar korrupsionin, por krahasuar me të dyja, ka më shumë qytetarë që mendojnë se SPAK është serioz në punën e tij.



Si mjet për parandalimin e korrupsionit në administratën publike, shumica e qytetarëve shohin një korrelacion pozitiv me pagesën e pamjaftueshme dhe pajtohen se rritja e pagave të nëpunësve civilë do të kontribuonte në uljen e korrupsionit.



Shumica e qytetarëve janë dakord se dixhitalizimi i shërbimeve ka kontribuar në uljen e korrupsionit, por megjithatë, rreth një e treta e tyre nuk mendojnë se ky proces ka dhënë efektet e pritshme.



Qytetarët janë të ndarë kur pyeten për portalin “Me ty Shqipëria që duam”. Rreth një e pesta thonë se portali ka qenë joefektiv ose shumë efektiv në uljen e korrupsionit dhe një e pesta tjetër thonë të kundërtën. Një e treta mendojnë se ka qenë disi efektive.




Rezultate të ngjashme janë marrë edhe mbi mendimi nëse krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka ndikuar pozitivisht në luftën kundër korrupsionit në çështjet e pronës. Por në këtë rast, ka një shumicë më të madhe që mendon se ngritja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me gjasa do të ketë një ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit në çështjet e pronës.



Për rëndësinë e kontributit në luftën kundër korrupsionit, mbi një e katërta e qytetarëve thonë se SPAK-u luan rolin më të rëndësishëm. Për sa i përket rëndësisë, shumica mendon se kontributi i SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit është domethënës. Megjithatë, gati gjysma e qytetarëve thonë se presin që qeveria të luajë një rol më të madh në luftën kundër korrupsionit.



Shumica dërmuese bien dakord se më shumë ndërgjegjësim dhe edukim për korrupsionin kontribuojnë në uljen e tij. Megjithatë, edhe pse ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve i miratuar në qershor të vitit 2016 është një instrument kyç kundër korrupsionit, dy të tretat e qytetarëve thonë se as nuk e njohin e as nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për këtë ligj.



Shumica e qytetarëve gjithashtu bien dakord se forcimi i integritetit të institucioneve publike do të reduktonte korrupsionin. Nga ana tjetër, ata janë të ndarë sa i përket efektivitetit të sistemit të kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë, i cili është një mekanizëm kyç për ndërtimin e integritetit.



Qytetarët janë të ndarë edhe për ndikimin e vetting-ut si mjet për uljen e korrupsionit në sistemin gjyqësor. Rreth një e treta e të anketuarve janë dakord se për shkak të procesit të vetting-ut ka më pak korrupsion në gjyqësor, ndërsa mbi një e treta mendojnë të kundërtën. Qytetarët janë gjithashtu më të ndarë sa i takon nivelit të besimit tek procesi i vetting-ut të gjyqtarëve dhe prokurorëve.




Nga ana tjetër, shumica mendon se vetting-u i politikanëve do të ulte korrupsionin. Shumë më shumë qytetarë mendojnë se pasurimi i paligjshëm duhet të konsiderohet krim në Kodin Penal.



Kur bëhet fjalë për denoncimin e korrupsionit, shumica e qytetarëve mendojnë si kanalet më të preferuara Policinë e Shtetit, median dhe SPAK-un. Megjithatë, shumica mendojnë se kanë frikë se do të kenë pasojë negative nëse do të denoncin një rast korrupsioni.




Pavarësisht shqetësimeve për pasojat e mundshme negative, qytetarët vlerësojnë në masë të madhe ata që denoncojnë korrupsionin. Shumica gjithashtu mbështet opsionin që ata që raportojnë akte korruptive duhet të mbrohen nga shpagimi.



Shumica e qytetarëve mendojnë se zyrtarët e administratës publike që denoncojnë korrupsionin nuk respektohen dhe mbrohen nga sistemi, por nga ana tjetër nuk janë dakord që ata zyrtarë të administratës publike që denoncojnë korrupsionin të dëmshpërblehen financiarisht për akte të tilla.



Lidhur me mbështetjen që BE-ja dhe SHBA-ja i japin Shqipërisë për të luftuar korrupsionin, shumica e qytetarëve mendojnë se një kontribut i tillë është i konsiderueshëm ose shume i konsiderueshëm. Megjithatë, ata kanë mendime të ndara për nivelin e zbatimit të rekomandimeve që i janë dhënë Shqipërisë nga aktorët ndërkombëtarë. Vetëm rreth një e treta e të anketuarve mendojnë se rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare zbatohen, dhe përqindje të ngjashme mendojnë se është e mundur që ato të zbatohen, ose rekomandimet nuk zbatohen.



Sa i përket lidhjes mes krimit të organizuar dhe korrupsionit, shumica dërrmuese prej 61.1% mendojnë se organizatat e krimit të organizuar e përdorin korrupsionin për të ndikuar në vendimmarrjen politike. Shumica mendojnë gjithashtu se krimi i organizuar ndikon në vendimmarrje si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, por një përqindje më e lartë mendon kështu për nivelin e qeverisjes vendore. Shumica e qytetarëve mendojnë gjithashtu se partitë politike financohen nga krimi i organizuar.



Përveç institucioneve politike, shumica e qytetarëve mendojnë se krimi i organizuar ndikon në vendimmarrjen e prokurorive dhe gjykatave, por më shumë mendojnë kështu për gjykatat.




Një përqindje më e vogël, por megjithatë shumica mendojnë se krimi i organizuar ndikon edhe tek raportimi i medias.

Informacion demografik

Kampioni përfshinte 1110 të anketuar, nga të cilët 50.7% ishin meshkuj dhe 49.3% femra. Grafiku i mëposhtëm jep shpërndarjen e ponderuar të kampionit për të katër grup moshat.


Shpërndarja e moshës



Grafiku 1. Shpërndarja e moshës së të anketuarve


Shumica e popullsisë së anketuar banon në zonat urbane dhe periferike, përkatësisht 56,7% dhe 9,6%. Më shumë se një e treta, 33,7%, e të anketuarve jetojnë në zonat rurale. Nuk vërehen ndryshime në krahasim me anketat e mëparshme.

Vendbanimi




Grafiku 2. Vendbanimi i të anketuarve

Për sa i përket arsimit, 54% e të anketuarve kanë të përfunduar arsimin e mesëm dhe gjithsej 30.9% kanë të përfunduar arsimin universitar dhe pasuniversitar. Krahësuar me anketat e mëparshme, ka një rritje të përqindjes së atyre që kanë mbaruar arsimin pasuniversitar dhe një rënie e atyre që thonë se kanë mbaruar vetëm arsimin e detyrueshëm është më e ulët (26,5% në 2020).




Grafiku 3. Niveli i arsimit të të anketuarve

Sa i përket përkatësisë etnike, 97,7% e të anketuarve janë shqiptarë, 1% grekë, 0,5% arumunë, 0,1% maqedonas (e veriut) dhe 0,6% i përkasin etnive të tjera. Përkatësia etnike e të anketuarve duket pothuajse identike me anketat e mëparshme të viteve 2019 dhe 2020.



Grafiku 4. Etnia e të anketuarve

Për sa i përket profesionit, pjesa më e madhe e të anketuarve janë deklaruar si të vetëpunësuar, 25.1%, pasuar nga 18.2%, 14.1% janë fuqi punëtore e pakualifikuar, 8.9% janë të grupuar si punëtorëve të nën- kualifikuar dhe sektori i arsimit dhe 8.2% janë studentë. Grafiku i mëposhtëm përshkruan ndarjen e plotë të të anketuarve sipas profesionit.



Grafiku 5. Profesioni i të anketuarve

Kërcënimet e sigurisë

Si në barometrat e mëparshëm, qytetarët u pyetën për perceptimet e tyre për kërcënimet e ndryshme të sigurisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë barometër, përfshihen disa pyetje mbi luftën në Ukrainë dhe rrit pasigurinë e sigurisë që rrjedh nga qëndrimi i Rusisë.


Për sa i përket kërcënimeve për sigurinë e Shqipërisë, qytetarëve iu drejtuan dy pyetje të veçanta për të identifikuar kërcënimin e parë dhe të dytë më të rëndësishëm. Ashtu si në barometrat e mëparshëm, korrupsioni është identifikuar si kërcënimi më i rëndë dhe i dyti më i rëndë i sigurisë nga shumica e qytetarëve: 39.3% mendojnë se korrupsioni është kërcënimi numër një i sigurisë, ndërsa 27.4% e identifikojnë atë si kërcënimin e dytë më të rëndësishëm të sigurisë.

30.2% e qytetarëve mendojnë se lufta me vendet e tjera është kërcënimi më serioz për sigurinë, ndërsa 19.1% e kanë identifikuar atë si kërcënimin e dytë më të rëndësishëm të sigurisë.

11.2% e qytetarëve e kanë identifikuar krimin e organizuar si kërcënimin më serioz të sigurisë, me 19.2% të tjerë që e konsiderojnë atë si kërcënimin e dytë më të rëndësishëm.

Një përqindje më e vogël e qytetarëve i shohin si kërcënim pandemitë, terrorizmin, migrantët e huaj, fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimatike dhe krimin kibernetik.

Kërcënimet kryesore ndaj sigurisë në Shqipëri




Grafiku 6. Kërcënimet më të rënda të sigurisë në Shqipëri

Nisur nga rritja e rëndësisë së sigurisë si shqetësim në nivele të ndryshme, qytetarëve iu kërkua të japin mendimin e tyre se si ndihen për sigurinë e tyre personale në të ardhmen në kontekstin e zhvillimeve në Shqipëri dhe në botë.

Atyre iu bënë dy pyetje: “A jeni të shqetësuar për zhvillimet e fundit në Shqipëri për sigurinë tuaj personale në të ardhmen?” dhe “A jeni të shqetësuar për zhvillimet më të fundit në botë për sigurinë tuaj personale në të ardhmen?”

Shumica dërmuese e të anketuarve, 86.4% shprehen se janë të shqetësuar për sigurinë e tyre personale në të ardhmen si rezultat i zhvillimeve të përgjithshme në Shqipëri, dhe pak më pak, por megjithatë shumica më e madhe 84.5% janë të shqetësuar për sigurinë e tyre personale në të ardhmen si rezultat i zhvillimet ndërkombëtare.


Shqetësim rreth zhvillimeve më të fundit në Shqipëri dhe botë për sigurinë tuaj të ardhme personale



Grafiku 7. Shqetësimi për sigurinë personale në të ardhmen

Si pyetje vijuese e shqetësimit për sigurinë personale në të ardhmen, në lidhje me zhvillimet në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, qytetarët u pyetën edhe për shqetësimin e perceptuar të tyre për sigurinë e brezave të rinj. Shumica dërmuese e të anketuarve, 90.4% shprehen se janë të shqetësuar për sigurinë e brezit të ri. Kjo përqindje është më e lartë se e atyre që shqetësohen për sigurinë e vetë atyre.

A mendoni se ngjarjet e fundit në Shqipëri e në botë mund të ndikojnë negativisht për brezat e rinj në jetën e tyre të ardhme?




Grafiku 8. Shqetësimi për sigurinë e brezave më të rinj në të ardhmen

Pushtimi rus i Ukrainës ka shkaktuar pasoja të shumta që kanë prishur normalitetin e furnizimit dhe kanë rritur pasigurinë. Qytetarëve iu kërkua të identifikonin se cila fushë e sigurisë mendojnë se është prekur.


70.0% e qytetarëve e identifikojnë sigurinë e ekonomisë, pasuar nga 26.1% që konstatojnë se agresioni ka shkaktuar efekte negative në furnizimin me energji. Një përqindje shumë e vogël prej 2.2% mendojnë se migrimi do të jetë një pasojë negative, dhe 1.1% mendojnë për sigurinë kibernetike.

Cila nga këto fusha do të ndikohen negativisht nga sulmi i Rusisë në Ukrainë?




Grafiku 9. Fushat e prekura nga lufta në Ukrainë

Pushtimi rus i Ukrainës ka ngritur shqetësime të mëdha në lidhje me zgjerimin e mundshëm të luftës në vendet e tjera evropiane. Shumica prej 58.7% mendojnë se një luftë midis Ruisë dhe Perëndimit është e mundur, ndërsa 36% mendojnë se lufta nuk do të zgjerohet për të përfshirë vende të tjera.



Grafiku 10. Opinioni mbi mundësinë e luftës ndërmjet Ruisë dhe Perëndimit

Për të marrë mendimin e qytetarëve në lidhje me qasjen e vendeve perëndimore ndaj Ruisë, atyre iu drejtua pyetja: “A mendoni se vendet perëndimore duhet të përmirësojnë marrëdhëniet me Ruisë apo të vendosin më shumë sanksione? Mendimi i tyre është mjaft i ndarë, megjithëse shumica e të anketuarve prej 55.8% mendojnë se vendet perëndimore duhet të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre me Ruisë, ndërsa 42.7% janë të mendimit se vendet perëndimore duhet të vendosin më shumë sanksione.




Grafiku 11. Opinioni nëse vendet perëndimore duhet të përmirësojnë marrëdhëniet me Ruisë apo të vendosin më shumë sanksione

Pavarësisht provave se agresioni rus në Ukrainë tregon mospërfillje flagrante të së drejtës ndërkombëtare, qëndrimi i Rusisë ka qenë se ajo është provokuar nga NATO dhe Perëndimi. Për të matur shkallën se sa mbështetet ky pretendim nga qytetarët shqiptarë, atyre iu drejtua pyetja: “Kush mendoni se ka më shumë përgjegjësi për përkeqësimin e situatës dhe luftës në Ukrainë?”.

Lidhur me opinionin për përgjegjësinë për përkeqësimin e situatës dhe luftës në Ukrainë, edhe pse 70,1% e qytetarëve mendojnë se përgjegjësia e agresionit bie mbi Rusinë, ka një përqindje të konsiderueshme që mendojnë se SHBA-ja dhe NATO-ja janë përgjegjëse për përkeqësimin e situatës dhe pushtimin e Rusisë në Ukrainë, përkatësisht 18,5% dhe 7,7%.


Opinion mbi përgjegjësinë e përkeqësimit të situatës dhe luftës në Ukrainë



Grafiku 12. Opinioni mbi marrëdhëniet me Rusinë në të ardhmen

Qytetarëve iu kërkua edhe që të shprehnin mendimin e tyre edhe për kërcënimin rus për sigurinë e Shqipërisë. Shumica prej 63.1% e të anketuarve e konsiderojnë Rusinë si një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë, por gati një e treta e tyre, 34.2%, mendojnë se Rusia nuk është një kërcënim.


A mendoni se Rusia është një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë?



Grafiku 13. Opinioni mbi kërcënimin për sigurinë e Shqipërisë nga Rusia

Në lidhje me kërcënimin ndaj sigurisë së Shqipërisë që paraqet Kina, vetëm 19% mendojnë se Kina është një kërcënim, ndërsa dy të tretat e të anketuarve, 76.6%, nuk e konsiderojnë Kinën si një burim kërcënim për sigurinë. Duket se ka një konsistencë në perceptimin e Kinës nga ana e qytetarëve shqiptarë. Barometri i Sigurisë 2019 dhe 2020 tregoi një përqindje të rritur të qytetarëve që e shihnin pozitivisht Kinën.


A mendoni se Kina është një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë?



Grafiku 14. Opinioni mbi kërcënimin për sigurinë e Shqipërisë nga Kina.


Qytetarët janë gjithashtu të ndarë për shkallën në të cilën veprimi i Rusisë ndaj Ukrainës përbën një kërcënim sigurie për Shqipërinë. Vetëm 15,1% e qytetarëve mendojnë se Rusia përbën një kërcënim shumë të madh dhe 37,1% të tjerë mendojnë se Rusia përbën një kërcënim të madh. Rreth 15% mendojnë

se veprimet e Rusisë përbëjnë një kërcënim shumë të vogël ose aspak për Shqipërinë dhe 31.6% mendojnë se kërcënimi është i vogël.




Grafiku 15. Opinioni për veprimin e Rusisë në Ukrainë dhe kërcënimin e sigurisë për Shqipërinë.

Nga ana tjetër, Rusia perceptohet se përbën një kërcënim të madh ose shumë të madh për rajonin e Ballkanit nga një përqindje më e lartë e qytetarëve, mbi 72%. Vetëm 25% mendojnë se kërcënimi për rajonin është i vogël ose nuk ka fare kërcënim.



Grafiku 16. Opinioni për veprimin e Rusisë në Ukrainë dhe kërcënimin e sigurisë për Ballkanin

Për sa i përket perceptimit të kërcënimit nga vendet e tjera të Ballkanit, vetëm Serbia shihet se paraqet një kërcënim për sigurinë nga një shumicë e madhe prej 66.8% dhe Greqia me 4.8%. 25% e qytetarëve nuk shohin asnjë vend në rajon si kërcënim.




Grafiku 17. Opinioni për kërcënimin që paraqesin vendet e Ballkanit
Perëndimor për sigurinë e Shqipërisë

Siguria bashkëpunuese

Bazuar në këtë përkufizim dhe supozime për sigurinë bashkëpunuese, qytetarëve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për ndikimin në sigurinë e Shqipërisë dhe pritshmëritë për NATO-n, OSBE-në dhe BE-në.

Lidhur me pyetjen “Cili është ndikimi i NATO-s, OSBE-së dhe BE-së në sigurinë e Shqipërisë?”, shumica e qytetarëve shqiptarë mendojnë se këto organizata kanë një ndikim pozitiv ose shumë pozitiv. Një përqindje shumë e vogël e të anketuarve mendojnë se këto organizata kanë ndikim negativ. Pavarësisht se është i vogël, vlen të theksohet se përqindja e atyre që mendojnë se BE-ja ka një ndikim negativ është gati dy herë ose tre herë më e lartë se ajo e NATO-s dhe OSBE-së përkatësisht.

Opinion rreth ndikimit të NATO-s, BE-së dhe OSBE-së në sigurinë në Shqipëri




Grafiku 18. Opinioni mbi ndikimin e NATO-s, BE-së dhe OSBE-së në sigurinë e Shqipërisë

Qytetarëve iu kërkua gjithashtu të japin mendimin e tyre se si mendojnë se do të jenë marrëdhëniet me këto organizata në të ardhmen: “Si mendoni se do të jenë marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n, BE-në dhe OSBE-në në 5-10 vitet e ardhshme?”


70% e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet me NATO-n do të forcohen në 5-10 vitet e ardhshme, ndërsa 67% mendojnë kështu për BE-në dhe 52% për OSBE-në. Megjithatë, ka një përqindje të konsiderueshme të atyre që shohin se

marrëdhëniet do të mbeten në të njëjtin nivel, kryesisht me OSBE-në, 42%. Vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve mendojnë se marrëdhëniet me këto organizata do të dobësohen, por si në rastin e rezultateve të pyetjeve të diskutuara në grafikun e mësipërm, përqindja e atyre që mendojnë se marrëdhëniet me BE-në do të dobësohen është më e lartë.



Grafiku 19. Opinioni për marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n, BE-në dhe OSBE-në në 5-10 vitet e ardhshme

Qytetarëve iu kërkua gjithashtu të shprehnin mendimin e tyre se për cilat prej këtyre organizatave ndërkombëtare Shqipëria duhet vendosë përparësi për zhvillimi të mëtejshëm të marrëdhënieve. Shumica e të anketuarve 50.3% mendojnë se Shqipëria duhet të ketë prioritet marrëdhëniet me BE-në, 35.6% me NATO-n dhe 7.7% me OSBE-në.



Grafiku 20. Përparësia e marrëdhënieve të Shqipërisë me NATO-n, BE-në, OSBE-në, OKB-në


Qytetarët u pyetën edhe për opinionin e tyre për vendet për të cilat Shqipëria duhet të vendosë përparësi për të zhvilluar më tej marrëdhëniet me to. Ashtu si në modelin e pyetjes me identifikimin e kërcënimeve për sigurinë e Shqipërisë, atyre iu kërkua të shprehnin mendimin e tyre për vendin me përparësi kryesore dhe vendin e dytë me përparësi.

“Me cilin nga vendet e mëposhtme Shqipëria duhet t’i japë përparësi kryesore marrëdhënieve? dhe “Përveç vendit të parë me përparësi kryesore, me cilat vende të tjera Shqipëria duhet tu japë përparësi kryesore marrëdhënieve?”

Shumica e qytetarëve mendojnë se Shqipëria duhet t’i japë përparësi kryesore marrëdhënieve të saj me Shtetet e Bashkuara, 70.1%. 16.7% e thonë këtë për Gjermaninë dhe 6.9% për Turqinë, pasuar nga përqindjet e vogla për Italinë, 2.7%, dhe Britaninë e Madhe, 1.7%.

Si zgjedhje e dytë, 42.7% mendojnë se Shqipëria duhet t’i japë përparësi marrëdhënieve me Gjermaninë, 16.5% me Turqinë, 15.5% me SHBA-në, 9.6% me Italinë dhe 8.4% me Britaninë e Madhe

Opinion rreth vendeve të mëdha me të cilat duhet t’i japë prioritet marrëdhënieve Shqipëria




Grafiku 21. Vendet të cilave Shqipëria duhet t’u japë prioritet në marrëdhëniet e saj të jashtme

Qytetarëve iu kërkua gjithashtu të japin mendimin e tyre se cili nga vendet e përmendura i ofron aktualisht Shqipërisë marrëdhëniet më të mira. Rezultatet tregojnë se ka një hendek mes cilit vend Shqipëria duhet t’i japë përparësi dhe marrëdhënieve dhe vendit që ofron marrëdhëniet më të mira.

Shumica e të anketuarve, 37.4%, mendojnë se në këtë moment Turqia ofron marrëdhëniet më të mira të Shqipërisë, po aq përqindje, 36.4%, mendojnë se këtë e bëjnë SHBA-të, 15.1% thonë Gjermania, 8% thonë Italia, 1.8% Britania e Madhe dhe 0.8 % Franca.


Cili nga vendet e mëposhtme i ofron aktualisht Shqipërisë marrëdhëniet më të mira?



Grafiku 22. Opinioni se cilat vende i ofrojnë Shqipërisë aktualisht marrëdhëniet më të mira

Rëndësia e sigurisë bashkëpunuese theksohet edhe nga opinioni i qytetarëve për pyetjen “A mund të mbrojë Shqipëria sovranitetin dhe sigurinë e saj pa ndihmën e vendeve aleate?”. 88.5% e të anketuarve mendojnë se Shqipëria nuk mund të garantojë sigurinë e saj pa mbështetjen e vendeve aleate. Megjithatë, 9.5% mendojnë se Shqipëria mund ta mbrojë vetë sovranitetin e saj.


A mundet Shqipëria të mbrojë sovranitetin dhe sigurinë e saj pa ndihmën e vendeve aleate?



Grafiku 23. Opinioni në lidhje me aftësinë e Shqipërisë për të mbrojtur vetë sovranitetin e saj

Një shumicë më e madhe e qytetarëve, 53.4%, mendojnë gjithashtu se Shqipëria do të jetë më e varur nga vendet aleate në 5-10 vitet e ardhshme për të garantuar sigurinë e saj dhe një 37.4% tjetër mendon se Shqipëria do të jetë aq e varur sa është aktualisht nga aleanca të tilla. Vetëm 6.4% mendojnë se zhvillimet e veta të sigurisë do ta lejojnë Shqipërinë të jetë më pak e varur.


Sa do të varet siguria dhe sovraniteti i Shqipërisë nga vendet aleate në 5-10 vitet e ardhshme?



Grafiku 24. Opinioni për varësinë e sigurisë së Shqipërisë nga vendet aleate për 5 deri në 10 vitet e ardhshme

Duke pasur parasysh rëndësinë e luftës në Ukrainë dhe implikimet për sigurinë evropiane, qytetarëve iu kërkua që të japin mendimin e tyre edhe nëse Shqipëria duhet të marrë pjesë ushtarakisht në mbrojtjen e Ukrainës. Pavarësisht kërcënimit rus të pranuar për sigurinë e Shqipërisë, vetëm 19.9% e qytetarëve mendojnë se Shqipëria duhet të marrë pjesë ushtarakisht në mbrojtjen e Ukrainës. Shumica, 71.3% e të anketuarve nuk e mbështetin pjesëmarrjen e Shqipërisë në luftë.

A duhet të marrë pjesë ushtarakisht Shqipëria në mbrojtjen e Ukrainës?



Grafiku 25. Opinioni nëse Shqipëria duhet të marrë pjesë ushtarakisht në mbrojtjen e Ukrainës


Duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në proceset integruuese, dhe ndikimin e integritetit rajonal në përmirësimin e sigurisë së përgjithshme, nga

qytetarët u kërkua të japin mendimin e tyre për nivelin e bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit. Shumica e të anketuarve, 72.3%, mendojnë se marrëdhëniet mes shteteve ballkanike janë aktualisht të cenuara nga mungesa e bashkëpunimit. 22.2% mendojnë se nuk ka një problem të tillë në rajon.



Grafiku 26. Opinion për nivelin e bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit

Qytetarëve iu kërkua gjithashtu të jepnin mendimin e tyre nëse Shqipëria duhet të zhvillojë një bashkëpunim më të ngushtë me të gjitha vendet e Ballkanit, për të përballuar kërcënimet e sigurisë, apo duhet ta bëjë këtë me disa vende specifike. Shumica e të anketuarve, 79.6%, mendojnë se Shqipëria duhet të zhvillojë një bashkëpunim më të ngushtë me të gjitha vendet e Ballkanit. Vetëm 19.4% mendojnë se bashkëpunimi duhet të kufizohet në disa vende.




Grafiku 27. Opinion për bashkëpunimin e Shqipërisë me të gjitha vendet e Ballkanit, apo vetëm me disa vende

Duke qenë se bashkëpunimi i sigurisë ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë mbetet më pak i zhvilluari, qytetarëve iu kërkua të japin mendimin e tyre nëse janë dakord që bashkëpunimi më i madh ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë do të çojë në një stabilitet më të madh në Ballkan.

Gati dy të tretat e të anketuarve, 74.4%, janë të mendimit se stabiliteti i Ballkanit do të përfitonte nga një bashkëpunim më i madh ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë. 21.8% kanë mendim të ndryshëm dhe 3.8% kanë refuzuar të japin një përgjigje.

A mendoni se një bashkëpunim më i madh ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë do të çojë në një stabilitet më të madh të Ballkanit?



Grafiku 28. Opinion për bashkëpunim më të madh ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë për të sjellë një stabilitet më të madh në Ballkan.

Qytetarët janë pyetur edhe për pritshmëritë e tyre për sigurinë në Ballkan në 5 vitet e ardhshme. Shumica e qytetarëve 73.7% janë optimistë dhe mendojnë se siguria në Ballkan do të përmirësohet, ndërsa 17.6% kanë mendim të ndryshëm, por një përqindje e konsiderueshme prej 8.7% nuk kanë pasur mendim ose kanë refuzuar të përgjigjen.


A mendoni se siguria në Ballkan do të përmirësohet gjatë 5 viteve të ardhshme?



Grafiku 29. Pritshmëria për përmirësimin e sigurisë në Ballkan në 5 vitet e ardhshme


Qytetarëve iu kërkua të japin mendimin e tyre se çfarë e pengon pajtimin dhe ndërtimin e paqes në Ballkan. Shumica e të anketuarve, 42.5%, mendojnë se përgjegjës janë politikanët që përfitojnë nga mbajtja gjallë e konfliktit. 28% të tjerë mendojnë se ndërhyrja e fuqive të mëdha e pengon këtë pajtim dhe ndërtim paqej. Megjithatë, 16.2% e të anketuarve mendojnë se popujt e Ballkanit ndihen të pasigurt për njëri-tjetrit dhe një pasiguri e tillë i pengon ata të afrohen më shumë së bashku.

Çfarë mendoni se e pengon bashkërendimin dhe ndërtimin e paqes në Ballkan?




Grafiku 30. Opinioni për faktorët që pengojnë pajtimin dhe ndërtimin e paqes në Ballkan

Përsa i përket fushave në të cilat Shqipëria duhet të bashkëpunojë më ngushtë me vendet e Ballkanit, 63,1% mendojnë se një bashkëpunim i tillë duhet të fokusohet në luftën kundër krimit të organizuar, 16,2% mendojnë terrorizmin, 10% mendojnë për fatkeqësitë natyrore dhe 6,5% për krimin kibernetik.



Grafiku 31. Opinioni për sfidat e sigurisë për të cilat Shqipëria duhet të bashkëpunojë më ngushtësisht me vendet e Ballkanit.


Qytetarët u pyetën edhe nëse mendojnë se Shqipëria ka statusin që e meriton në botë. Shumica e të anketuarve, 66.5%, nuk janë të lumtur dhe mendojnë se Shqipëria duhet të ketë një status më të mirë në botë. 30.2% mendojnë se aktualisht Shqipëria ka statusin që meriton në skenën botërore.



Grafiku 32. Opinioni për statusin e Shqipërisë në skenën botërore

Për të përmirësuar statusin e saj në skenën botërore, 77.5% e qytetarëve mendojnë se Shqipëria duhet të fokusohet në zhvillimin ekonomik dhe social, ndërsa 21.2% mendojnë se një status i tillë mund të arrihet duke investuar më shumë në sektorin e sigurisë.


Për të përmirësuar staturën e saj në botë, Shqipëria duhet të investojë më shumë për zhvillimin ekonomiko-social apo për sektorin e sigurisë?



Grafiku 33. Opinioni për mënyrat për të përmirësuar statusin e Shqipërisë në skenën botërore

Megjithatë, ka pothuajse unanimitet se Shqipëria duhet të bëjë më shumë për të forcuar Mbrojtjen dhe Forcat e Armatosura (97.5%), Policinë (97.3%), Shërbimin Informativ (95.7%) dhe Diplomacinë (97.1%).


Opinion nëse Shqipëria duhet të forcojë strukturat e saj të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, Shërbimeve Inteligjente dhe shërbimet diplomatike



Grafiku 34. Opinioni nëse Shqipëria duhet të forcojë sektorin e saj të mbrojtjes, policinë, shërbimin informativ dhe diplomacinë.


Siguria dhe barazia gjinore

Përsa i përket sigurisë së grave në shoqëri, shumica e qytetarëve, 68.7%, mendojnë se gratë janë më pak të sigurta se burrat në Shqipëri. Përqindja e femrave që kanë një mendim të tillë është më e lartë, 74.9%.




Grafiku 35. Opinioni në lidhje me sigurinë e grave në jetën e tyre të përditshme në Shqipëri

Një shumicë më e madhe e qytetarëve gjithashtu pajtohen se dhuna në familje drejtohet kryesisht ndaj grave, 86,5%, dhe ashtu si më lart, përqindja e grave të anketuara që mendojnë kështu është më e lartë, 90,1%.




Grafiku 36. Opinioni nëse dhuna në familje drejtohet kryesisht kundër grave

Nga ana tjetër, mbizotëron pranimi nga të anketuarit se dhuna ndaj grave është një fenomen shqetësues, 92,6%, dhe sërish përqindja e grave që mendojnë kështu është gjithashtu më e lartë, 95,3%.



Grafiku 37. Opinioni nëse dhuna kundër grave është një fenomen shqetësues


Qytetarëve iu kërkua gjithashtu të jepnin mendimin e tyre nëse ekzistojnë kuadri politik dhe ligjor për garantimin e sigurisë së barabartë për burrat dhe gratë. Me një ndryshim të vogël nga të anketuarat femra, të cilat priren të mos pajtohen, shumica e qytetarëve mendojnë se ekzistojnë politika dhe ligje që garantojnë siguri të barabartë për burrat dhe gratë 68.8%.



Grafiku 38. Opinioni nëse politikat dhe ligjet garantojnë siguri të barabartë për burrat dhe gratë


Duke qenë se hendeku ekonomik midis burrave dhe grave shpesh konsiderohet si burim i dhunës në familje, qytetarëve iu kërkua të japin mendimin e tyre nëse

fuqizimi më i madh ekonomik i grave do të çonte në uljen e dhunës në familje. Shumica dërrmuese, 82%, pajtohen se fuqizimi më i madh ekonomik i grave do të reduktonte dhunën në familje dhe më shumë gra priren të mendojnë kështu, 87.2%.



Grafiku 39. Opinioni nëse fuqizimi më i madh ekonomik i grave do të reduktonte dhunën në familje

Gati 60% mendojnë se gratë janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në shërbimet policore, por përqindja e grave që mendojnë kështu është më e vogël, 56.4%.




Grafiku 40. Opinioni në lidhje me përfaqësimin e mjaftueshëm të grave në shërbimet e policisë

Ndryshe nga përfaqësimi i grave në polici, qytetarët priren të mos pajtohen se gratë janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në forcat e armatosura. Vetëm

42.6% mendojnë se po, dhe për këtë kriter duket të ketë të njëjtin nivel të pajtimit edhe nga femrat e anketuara.


A jeni dakord me rritjen e përfaqësimit të grave/vajzave në shërbimet e forcave të armatosura?



Grafiku 41. Opinioni në lidhje me mjaftueshmërinë e përfaqësimit të grave në forcat e armatosura


Edhe pse ka më shumë qytetarë që mendojnë se gratë janë të përfaqësuar në mënyrë të mjaftueshme në polici, ekziston një konsensus mbizotërues që përfaqësimi i grave duhet të rritet si në polici ashtu edhe në forcat e armatosura. Megjithatë, më shumë qytetarë, 86,6% janë pro rritjes së përfaqësimit të grave në polici sesa në forcat e armatosura, 75,7%.

Opinion mbi rritjen e përfaqësimit të grave/vajzave në shërbimet e forcave të armatosura dhe polici




Grafiku 42. Opinioni mbi rritjen e përfaqësimit të grave në polici dhe forcat e armatosura

Në përgjithësi, qytetarët mendojnë se nuk ka pengesa për gratë që bëhen pjesë e policisë. 86,6% mendojnë se si burrat ashtu edhe gratë kanë mundësi të barabarta kur aplikojnë për t'u bashkuar me policinë.



Grafiku 43. Opinioni në lidhje me mundësinë e barabartë për tu bërë pjesë e policisë nga gratë

Megjithatë, ka më pak marrëveshje për përfaqësimin e grave në nivelet drejtuese dhe udhëheqëse të policisë. Vetëm 53.75 % mendojnë se gratë janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në pozitat drejtuese dhe udhëheqëse.




Grafiku 44. Opinioni për mjaftueshmërinë e përfaqësimit të grave në pozicione drejtuese dhe udhëheqëse në polici

Megjithatë, duket se ka disa paragjykime mbi masën në të cilën qytetarët mendojnë se gratë mund të kryejnë funksione policore në të njëjtën mënyrë si burrat, dhe këtë mendim e ndajnë të anketuarit meshkuj dhe femra.

Qytetarët u pyetën edhe për perceptimet e tyre për përshtatshmërinë e burrave për të kryer funksione në shërbimet policore. Rezultatet e mëposhtme tregojnë se shumica e të anketuarve mendojnë pozitivisht dhe vetëm 2.2% refuzojnë të përgjigjen. 80.2% e qytetarëve mendojnë se meshkujt janë më të përshtatshëm për të kryer funksionet që kryejnë shërbimet e policisë.


A janë burrat më të përshtatshëm për të kryer funksionet në shërbimet e policisë?



Grafiku 45. Opinioni në lidhje me përshtatshmërinë e burrave për të kryer funksione në shërbimet e policisë

Shumica dërrmuese e qytetarëve mendojnë se femrat janë të përfaqësuar në mënyrë të mjaftueshme në politikë, 85,3% dhe me një ndryshim shumë të vogël ky mendim ndahet edhe nga femrat e anketuara, 82,9%.

A janë grate/vajzat të përfaqësuara në mënyrë të përshtatshme në politikë?




Grafiku 46. Opinioni në lidhje me përfaqësimin e grave në politikë

Duke pasur parasysh rëndësinë e temës së korrupsionit dhe krimit të organizuar për Shqipërinë, dhe supozimin se gratë janë më pak të korruptuara se burrat ose më pak të prirura për t'u përfshirë në aktivitete kriminale, qytetarët u pyetën nëse bien dakord ose jo në lidhje me pyetjen “A janë gratë/vajzat po aq të prirura sa edhe burrat për t'u përfshirë në korrupsion?” dhe “A janë gratë/vajzat po aq të prirura sa edhe burrat për t'u përfshirë në krimin e organizuar?”.


Shumica e qytetarëve mendojnë se gratë janë më pak të prirura se sa burrat për t'u përfshirë si në krimin e organizuar dhe në veprime korruptive. Megjithatë, ka një përqindje më të lartë të të anketuarve, 30%, të cilët mendojnë se gratë dhe burrat janë njëloj të prirur ndaj korrupsionit, në krahasim me 15.7% që mendojnë kështu për prirjen e grave për t'u përfshirë në krimin e organizuar.

A janë gratë/vajzat më të prirura për t'u përfshirë në krimin e organizuar dhe korrupsion?



Grafiku 47. Opinioni në lidhje me prirjen e një gruaje për tu përfshirë në veprime korruptive dhe të krimit të organizuar

Ka njëfarë dallimi ndërmjet gjinisë së të anketuarve pasi ka një përqindje pak më të lartë të të anketuarve femra që mendojnë se gratë janë më pak të prirura ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, krahasuar me kampionin e plotë të të anketuarve të mësipërm.




Grafiku 48. Opinioni i të anketuarve meshkuj dhe femra për prirjen e grave për tu përfshirë në veprime korruptive dhe të krimit të organizuar

Korrupsioni dhe anti-korrupsioni

Duke qenë se korrupsioni vazhdon të jetë një nga shqetësimet kryesore për shoqërinë shqiptare në përgjithësi dhe institucionet e sigurisë në veçanti, ky edicion i barometrit shqyrtoi perceptimet e qytetarëve për përhapjen e korrupsionit në këto institucione dhe për besimin e tyre tek institucionet e sigurisë dhe institucionet që i kontrollojnë dhe mbikëqyrin ato.

Rezultatet tregojnë se shumica e qytetarëve mendojnë se kërcënimi i korrupsionit në Shqipëri është i madh 49.3%, ose shumë i madh 37.7%.




Grafiku 49. Opinioni në lidhje me nivelin e kërcënimit nga korrupsioni në Shqipëri

Për të marrë opinionin e qytetarëve për efektivitetin e reformave anti-korrupsion të kryera gjatë viteve të fundit, atyre iu drejtua pyetja “Si është korrupsioni sot, krahasuar me 5 vite më parë?”.

Shumica e kombinuar e qytetarëve, 52.3%, mendojnë se korrupsioni gjatë pesë viteve të fundit është rritur ndjeshëm (22.2%) ose është rritur (30.1%). Një tjetër 32,2% mendojnë se korrupsioni është i njëjtë me pesë vjet më parë, dhe vetëm 15,4% mendojnë se korrupsioni është reduktuar ose reduktuar ndjeshëm.


Krahasuar me 5 vjet më parë, korrupsioni sot është?



Grafiku 50. Opinioni në lidhje me tendencën e korrupsionit në pesë vitet e fundit

Të pyetur për perspektivën e rezultateve të luftës kundër korrupsionit, gjysma e qytetarëve thonë se korrupsioni do të mbetet i njëjtë edhe në vitet e ardhshme, ndërsa 19.5% mendojnë se nivelet e korrupsionit do të rriten në të ardhmen. Vetëm 27.1% janë optimistë dhe mendojnë se korrupsioni do të reduktohet.


Mendoni se në vitet e ardhshme korrupsioni do të jetë në nivel?



Grafiku 51. Opinioni në lidhje me pritshmëria për tendencën e korrupsionit në vitet e ardhme


Sa i përket shkaqeve të korrupsionit, shumica e qytetarëve, 31%, mendojnë se shkak kryesor i korrupsionit është dobësia e institucioneve. Një tjetër 28,9% mendojnë se pushteti i oligarkëve në shoqëri është shkaktari kryesor i

korruptionit, ndërsa 19,5% mendojnë për dobësinë e demokracisë. Një tjetër 19.3% mendojnë se shkaku kryesor është tolerimi i korruptionit nga qytetarët.




Grafiku 52. Opinioni në lidhje me shkaqet e korruptionit

Përsa i përket pyetjes se kush është përgjegjës për vazhdimësinë e korruptionit në Shqipëri, shumica dërrmuese e qytetarëve, 73.2%, identifikojnë politikanët, ndërsa 14.7% thonë se përgjegjëse është administrata publike. 7.7% e tjerë mendojnë se qytetarët janë përgjegjës për vazhdimësinë e korruptionit, me veprimet apo mosveprimet e tyre.



Grafiku 53. Opinioni në lidhje me faktorët përgjegjës për vazhdimësinë e korruptionit

Për të eksploruar marrëdhënien mes politikës dhe biznesit, qytetarët janë pyetur nëse partitë politike marrin financime nga bizneset në këmbim të favoreve. Shumica prej 75.6% mendojnë se partitë politike marrin financime nga bizneset në këmbim të favoreve dhe vetëm 4.2% mendojnë të kundërtën.




Grafiku 54. Opinioni në lidhje me financimin e partive politike nga bizneset në shkëmbim të favoreve

Luftimi i korrupsionit në punësimet në administratën publike dhe në fushën e prokurimeve kanë qenë subjekt i reformave gjatë viteve të fundit.

Qytetarëve iu bënë pyetjet “A është rritur korrupsioni në punësimet në administratën publike në 3 vitet e fundit?” dhe “A është rritur korrupsioni në prokurime në 3 vitet e fundit?” me synimin për të verifikuar ndikimin e reformave të tilla. Rezultatet tregojnë se vetëm rreth 12% mendojnë se korrupsioni në punësimin në administratën publike është ulur, ose është ulur ndjeshëm, dhe një përqindje e vogël prej 9.6% mendojnë kështu për prokurimet.

Shumica dërrmuese e qytetarëve mendojnë se korrupsioni në këto fusha ose është i njëjtë, është rritur ose është rritur ndjeshëm, siç detajohet në grafikun e mëposhtëm.

Tendenca e korrupsionit tek punësimet në administratën publike dhe procedurat e prokurimeve




Grafiku 55. Opinioni në lidhje me korrupsionin në punësimet në administratën publike dhe në prokurimet publike në 3 vitet e fundit

Nisur nga rëndësia e transparencës në luftën kundër korrupsionit si dhe për të verifikuar efektet e përpjekjeve institucionale për rritjen e transparencës së institucioneve, nga qytetarët u kërkuar të japin mendimin e tyre nëse është rritur transparenca e përgjithshme e institucioneve.


Shumica e të anketuarve, 45.8% u shprehën se transparenca e institucioneve ka mbetur e njëjtë. Vetëm 7.4% thonë se transparenca është rritur ndjeshëm dhe 27.3% thonë se transparenca është rritur ose është rritur disi. Nga ana tjetër, janë edhe rreth 17% që thonë se transparenca është ulur në 3 vitet e fundit.

Gjatë tre viteve të fundit, mendoni se transparenca e institucioneve shtetërore ndaj publikut është?



Grafiku 56. Opinioni në lidhje me transparencën e institucioneve në 3 vitet e fundit

Përgjigje të ngjashme janë dhënë edhe për sa i përket transparencës në vendimarrje. Vetëm 22.5% mendojnë se institucionet qeveritare kanë qenë më transparente në vendimarrje në 5 vitet e fundit dhe 33% të tjerë nuk janë aq të sigurt. Shumica prej 40.9% thonë se institucionet qeveritare nuk kanë qenë më transparente në vendimarrje.




Grafiku 57. Opinioni në lidhje me transparencën e institucioneve qeveritare në vendimarrje në 5 vitet e fundit

Për të marrë mendimin e qytetarëve për vullnetin dhe përkushtimin e institucioneve përkatëse të përfshira në luftën kundër korrupsionit, atyre iu drejtuan këto pyetje: “A mendoni se gjykatat anti-korrupsion janë serioze në luftën kundër korrupsionit?”, “A mendoni se SPAK është serioz në luftën kundër korrupsionit?” dhe “A mendoni se qeveria është serioze në luftën kundër korrupsionit?”.

Rezultatet tregojnë variacione ndërmjet angazhimit të qeverisë dhe gjyqësorit. Vetëm 23% thonë se qeveria është serioze në luftën kundër korrupsionit, 25,9% thonë kështu për gjykatat anti-korrupsion dhe një përqindje më e lartë prej 38,4% mendojnë se SPAK është serioz në luftën kundër korrupsionit.

Opinion mbi seriozitetin e qeverisë, gjykatave antikorrupsion dhe SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit




Grafiku 58. Opinioni për seriozitetin e qeverisë, gjykatave anti-korrupsion dhe SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit

Pagesa e pamjaftueshme shpesh shihet si një motivim për korrupsion, pasi nëpunësit publikë kthehen në përdorimin e pozicionit të tyre zyrtar për të nxjerrë përfitime monetare dhe/ose materiale për të përmbushur nevojat e tyre. Qytetarëve iu drejtua pyetja “A mendoni se rritja e pagave të nëpunësve civilë do të ulë korrupsionin?” dhe “A mendoni se rritja e pagave të policëve do të ulë korrupsionin?” për të marrë mendimin e tyre për korrelacionin ndërmjet pagesës së pamjaftueshme dhe korrupsionit për këto dy kategori specifike të zyrtarëve publikë.

Rezultatet janë pothuajse identike për të dyja. Shumica prej pak më shumë se 50% mendojnë se rritja e pagave do të çonte në uljen e korrupsionit të nëpunësve civilë dhe punonjësve të policisë, dhe 18.8% dhe 21% të tjerë mendojnë se kjo mund të jetë e mundur për nëpunësit civilë dhe punonjësit e policisë përkatësisht. Rreth një e treta e të anketuarve mendojnë të kundërtën, dhe kjo mund të lidhet fare mirë me besimin se korrupsioni është i rrënjësor thellë dhe se motivuesi nuk është mungesa e pagave të mjaftueshme, por vazhdimi i pasurimit nëpërmjet shpërdorimit të detyrës.

Opinion mbi korrelacionin mes rritjes së pagave dhe uljes së korrupsionit



Grafiku 59. Opinioni për korrelacionin ndërmjet pagesave të pamjaftueshme dhe korrupsionit


Si pjesë reformave anti-korrupsion, qeveria ka intensifikuar veprimet për dixhitalizimin e shërbimeve publike, ngritjen e platformës online për raportimin e problemeve me të cilat përballen qytetarët kur ato marrin shërbime publike dhe në kuadër të menaxhimit të pronësisë është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës për centralizimin e shërbimeve.

Për sa i përket dixhitalizimit të shërbimeve përmes e-Albania, qytetarëve iu drejtua pyetja “A mendoni se dixhitalizimi i shërbimeve (e-Albania) ka kontribuar në uljen e korrupsionit?”

Shumica prej 44.5% thonë se dixhitalizimi i shërbimeve ka kontribuar në uljen e korrupsionit dhe 20.1% të tjerë mendojnë se mund të jetë kështu. Megjithatë, rreth një e treta e të anketuarve nuk janë dakord që platforma e-Albania ka kontribuar në uljen e korrupsionit.

Janë vërejtur disa luhatje midis të anketuarve në varësi të vendbanimit të tyre. Ka një përqindje më të vogël të qytetarëve që jetojnë në zona rurale dhe periferike që bien dakord se platforma e-Albania ka kontribuar në uljen e korrupsionit, gjë e cila mund të lidhet me aksesin në internet dhe pasjen e pajisjeve të përshtatshme.

**A mendoni se dixhitalizimi i shërbimeve (eAlbania) ka
kontribuar në uljen e korrupsionit?**




Grafiku 60. Opinioni nëse dixhitalizimi i shërbimeve (e-Albania) ka kontribuar në reduktimin e korrupsionit

Qytetarët janë shumë më shumë të përçarë kur pyeten për portalin “Me ty Shqipëria që duam”. Ndaj pyetjes “Nga përvoja juaj apo nga ato që keni dëgjuar, a është portali “Me ty Shqipëria që duam” efektiv në uljen e korrupsionit? Një përqindje e konsiderueshme e qytetarëve prej 14.8% nuk kanë ditur ose kanë refuzuar të përgjigjen. Kjo pyetje mori përqindjen më të lartë të “nuk e di/refuzoi të përgjigjet” nga të gjitha pyetjet e barometrit.

Një total prej rreth 22% thotë se portali “Me ty Shqipëria që duam” ka qenë shumë efektiv apo efektiv, ndërsa nga ana tjetër një total prej rreth 30% thotë se ka qenë shumë joefektiv apo joefektiv. Rreth 33% thonë se ka qenë disi efektiv. Ashtu si në rastin e platformës e-Albania ka një përqindje më të vogël të qytetarëve që jetojnë në zonat rurale dhe periferike që thonë se portali “Me ty Shqipëria që duam” ka qenë efektiv apo shumë efektiv.


Me sa keni provuar apo dëgjuar, a është efektiv në uljen e korrupsionit Portali “Me ty Shqipëria që duam”?



Grafiku 61. Opinioni nëse portali “Me ty Shqipëria që duam” është efektiv në reduktimi e korrupsionit

Qytetarët janë më pak të ndarë për ndikimin e krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, megjithëse vetëm 29.2% presin që krijimi i saj të ketë ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit në ofrimin e shërbimeve për çështjet e pronës. Shumica prej 41.5% mendojnë se kjo mund të jetë e mundur. Në këtë rast kemi një përqindje pak më e lartë të atyre qytetarëve që jetojnë në zonat rurale dhe periferike të cilët mendojnë se ngritja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës do të ndikojë pozitivisht në luftën kundër korrupsionit.

A mendoni se krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës do të ndikojë pozitivisht në luftën kundër korrupsionit në çështjet e pronësisë?




Grafiku 62. Opinioni nëse krijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës ka pasur një ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit në çështjet e pronës

Duke qenë se lufta kundër korrupsionit përfshin angazhimin e një sërë palësh të interesit qeveritare dhe joqeveritare, qytetarëve iu kërkua të tregojnë institucionet apo aktorëve që luajnë rolin më të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit sipas këndvështrimeve të tyre.

Në përgjithësi qytetarët janë të ndarë në këtë çështje, por shumica prej 28% mendojnë se SPAK-u është lojtari më i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. 23.4% mendojnë se qeveria është një lojtar i tillë dhe një përqindje më e vogël prej rreth 6.5% mendojnë se Policia e Shtetit dhe Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit (Drejtoria e Përgjithshme Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë). Një përqindje shumë më e vogël mendon për Parlamentin dhe administratën publike.

Media vlerësohet si një aktor i rëndësishëm me 20% dhe shoqëria civile me 6.7%, çka sugjeron se qytetarët vlerësojnë edhe kontributin e aktorëve joqeveritarë në luftën kundër korrupsionit.

Cili nga këto (institucione) mendoni se luan aktualisht rolin më të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit?




Grafiku 63. Opinioni në lidhje me institucionet që luajnë rolin më të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit

Qytetarët u pyetën gjithashtu se “Cili prej këtyre (institucioneve) dëshironi të luajë një rol më të madh në luftën kundër korrupsionit?”, duke përfshirë të njëjtat institucione dhe aktorë.

Shumica prej 47.6% shprehen se ata duan që qeveria të luajë një rol më të madh në luftën kundër korrupsionit dhe 21.3% të tjerë shprehen kështu për SPAK. Pritshmëri më të mëdha kanë 11.2% e qytetarëve edhe tek Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit (Drejtoria e Përgjithshme Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë).


Kush dëshironi të luajë një rol më të madh në luftën kundër korrupsionit?



Grafiku 64. Opinioni për institucionet që qytetarët duan të luajnë një rol më të madh në luftën kundër korrupsionit

Të pyetur konkretisht për kontributin absolut të SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit, rezultatet tregojnë se shumica e të anketuarve 26.8% mendojnë se kontributi i SPAK-ut është shumë i rëndësishëm dhe 42.7% e tjerë mendojnë se është i rëndësishëm. Vetëm rreth 8% mendojnë se është i parëndësishëm ose shumë i parëndësishëm.


Si do ta vlerësonit kontributin e SPAK-ut në luftën kundër korrupsionit?



Grafiku 65. Opinioni në lidhje me kontributin e SPAK në luftën kundër korrupsionit

Qytetarëve iu kërkua që të jepnin opinionin e tyre edhe në lidhje me pritshmëritë për efektivitetin e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BHK). Edhe pse BKH filloi ka filluar të funksionojë që nga gushti 2021, qytetarët duket se kanë pritshmëri të moderuara. Vetëm një e treta e të anketuarve mendojnë se ajo do të jetë efektive, ndërsa shumica prej 48.3% mendojnë se mund të jetë efektive. Megjithatë, përqindja e atyre që thonë me vendosmëri se kjo strukturë do të jetë joefektive është mjaft e vogël, vetëm 11.7%.


A mendoni se Byroja Kombëtare e Hetimit do të jetë efektive?



Grafiku 66. Opinioni nëse Byroja Kombëtare e Hetimit do të jetë efektive


Sinjalizimi është njohur sa vjen e më shumë si një mjet i rëndësishëm për të luftuar korrupsionin pasi sinjalizuesit janë në pozicionin më të mirë për të parandaluar

parregullsitë ose për të informuar për një krim korrupsioni. Shqipëria miratoi Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Qershor 2016. Megjithatë, vetëm 26.8% thonë se kanë dëgjuar për këtë ligj, ndërsa shumica e tyre thonë se as nuk e njohin e as nuk kanë dëgjuar për ligjin.




Grafiku 67. Opinioni në lidhje me njohuritë për ligjin për sinjalizimin

Shumica e qytetarëve 68,1% pajtohen se sensibilizimi dhe edukimi për korrupsionin do të kontribuojë në uljen e tij dhe 23,1% të tjerë thonë se kjo është e mundur. Vetëm rreth 8% mendojnë ndryshe. Një përqindje më e lartë e qytetarëve me arsim universitar, 89.4% mendojnë se më shumë ndërgjegjësim dhe edukim do të kontribuojë në uljen e korrupsionit.




Grafiku 68. Opinioni nëse ndërgjegjësimi dhe edukimi mbi korrupsionin do të kontribuojë në reduktimin e tij

Ndërtimi i integritetit është një komponent i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit sepse parandalon korrupsionin. Ekziston një konsensus mes qytetarëve se forcimi i integritetit të institucioneve publike kontribuon në uljen e korrupsionit. Shumica prej 65.2% e qytetarëve janë plotësisht dakord dhe 25.3% mendojnë se kjo është e mundur. Vetëm një pakicë prej 7.8% mendojnë të kundërtën.



Grafiku 69. Opinioni nëse forcimi i integritetit të institucioneve publike do të reduktojë korrupsionin

Për sa i përket efektivitetit të kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë, qytetarët janë më të ndarë. 31.7% janë plotësisht dakord që sistemi është efektiv dhe po aq përqindje, 29.2% mendojnë të kundërtën. 33.6% mendojnë se sistemi ka mundësi të jetë efektiv dhe një përqindje e konsiderueshme prej 5.5% nuk dinë ose refuzojnë të përgjigjen.




Grafiku 70. Opinioni mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të pasurisë dhe konfliktit të interesit të zyrtarëve publikë

Vetting-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve është konceptuar si një nga gurët e themelimit të luftës kundër korrupsionit në gjyqësor. Pas afro 5 vitesh që kur ka nisur procesi, qytetarët janë të ndara për rezultatet e vetting-ut.

